REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr 2167/1 *prot.* *Lezhë, më:* 05-11-.2026

RELACION
PËR SHPJEGIMIN E PROCEDURËS TË HEQJES NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR PËR SIPËRFAQET PYJORE/KULLOSORE BASHKIAKE DHE PRIVATE QË DO TË PREKEN NGA KRYERJA E AKTIVITETIT MINERAR TË SHFRYTËZIMIT TË GURIT GËLQEROR, NË OBJEKTIN BALLDRE, NGA SHOQËRIA "LEZHA KONSTRUKSION" sh.p.k.

Shoqëria **"LEZHA KONSTRUKSION" sh.p.k.** ka paraqitur kërkesën online me datë 28.07.2026 pranë Ministrisë së Mjedisit, bazuar në Lejen e Shfrytëzimit minerar numër 647/3, datë 22.04.2024 dhënë për shoqërinë "Alba Kurbin" sh.p.k dhe transferuar me Aktin e Miratimit numër 647/4 nga MIE, si dhe Leje Mjedisi të tipit B me numër identifikimi 5049, datë 04.06.2026, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zhvillimin e aktivitetit minerar të shfrytëzimit të gurit gëlqeror në objektin **BALLDRE**, Ekonomia Pyjore Mali i Kakarriqit, Njësia Administrative Balldre, Bashkia Lezhë.

Bazuar në ligjin 57/2020 datë 30.4.2020 "Për Pyjet", si dhe në VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", kërkesa i drejtohet Këshillit Bashkiak për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor kombëtar sipërfaqen prej **4.64 ha** kullotë që do të shërbejë për kryerjen e aktivitetit minerar.

Ministria Mjedisit, nëpërmjet shkresës së datës 19.08.2026 e admnistruar pranë Bashkisë Lezhë me numër 17686 protokoll datë 14.09.2025 i është drejtuar Bashkisë Lezhë për hartimin e Raportit Tekniko-ekonomik dhe dhënien e dakortësisë me vendim të Këshillit Bashkiak për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes që preket nga leja e aktivitetit minerar, sipas përcaktimit në pikën 2/d, kapitulli III të VKM-së numër 888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor publik apo zgjerimin e tyre".

Nga ana e Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, Bashkia Lezhë është përgatitur raporti tekniko-ekonomik për sipërfaqet pyjore që preken nga zhvillimi i aktivitetit minerar.

Sipërfaqet pyjore janë në pronësi të Bashkisë Lezhë sipas VKM-së nr.433 dt.08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit,

dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive", të ndryshuar dhe bëjnë pjesë në ngastrat pyjore **31, 31b** dhe **15e** të Ekonomisë Pyjore "**Mali i Kakarriqit**". Pasuria numër **682/2, ZK 1783** është **Pronë Private** në emër të personit juridik **LEZHA KONSTRUKSION**, në Ekonominë Pyjore "**Mali i Kakarriqit**" dhe i hiqet parcelës numër **31b**.

Në këto kushte, bazuar në ligjin numër 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", ligjin numër 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", VKM-në numër 888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", i propozojmë Këshillit Bashkiak të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor publik sipërfaqen prej **4.64 ha** kullotë nga e cila **3.27 ha** është në pronësi të Bashkisë dhe **1.37 ha** në pronësi private, sipas raportit tekniko-ekonomik bashkangjitur Projekt-Vendimit.

Hartoi relacionin
Inxh. Artan PALUSHI

DREJTORI
Paulin GJERGJI

KRYETARI
Pjerin NDREU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LEZHË